

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6993
E hënë, 11 shtator 2023
Çmimi 0.40

Bumi turistik në
Shqipëri: Njerëzit janë
shumë miqësorë FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA: KURTI TË RAPORTOJË NË KUVEND PARA TAKIMIT ME VUÇIQIN FAQE 4-5



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë kërkuar që kryeministri Albin Kurti të raportojë në Kuvend para

takimit të 14 shtatorit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Sipas opozitës, vendi është në terr informativ sa i përket ecurisë së dialogut me Serbinë.

Opozita thotë se nuk pret diçka të re nga ky takim për arsye se të gjitha marrëveshjet që janë bërë në kohën e Kurtit ende nuk janë zbatuar

AKTUALE



OSMANI MERR PJESË NË TAKIMIN E LIDERËVE TË RAJONIT NË PROCESIN BRDO-BRIONE QË MBAHET NË SHKUP F. 3

AUTOBUSËT E TRAFIKUT URBAN SË SHPEJTI ME WI-FI F. 6

DREJTORESHA E ARSIMIT NË MITROVICË: 38 % E NXËNËSVE NUK KANË TEKSTE SHKOLLORE F. 6

EKONOMI



DIMËR STABIL ME RRYMË, POR ME ÇMIME TË PAPANASHIKUESHME F. 8


RRITEN ÇMIMET E PERIMEVE NË PRISHTINË, ANKOHEN QYTETARËT F. 8

SPORT



SHOIPËRIA 'FUNDOS' POLONINË, 'EURO 2024' EDHE MË AFËR F. 10

MAROKU I SHKATËRRUAR NGA TËRMETI, SHKON NË 2 000 NUMRI I VIKTIMAVE



RASHIQI E AKUZON
SERBINË PËR SHANTAZH
DHE I KËRKON TA LIROJË
DREJTORIN E LEPOSAVIQIT FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maroku i shkatërruar nga tërmeti, shkon në 2 000 numri i viktimave

RABATI, 10 SHTATOR - Ekipet e shpëtimit janë në luftë me kohën për t'i nxjerrë të mbijetuarit nga rrënojat në Marok pas tërmetit shkatërrimtar, por shpresat po shuhen gjithnjë e më shumë me kalimin e orëve.

Bilanci i viktimave është rritur frikshëm, duke u regjistruar të paktën 2 000 të vdekur, ndërsa më shumë se 1 400 kanë marrë lëndime të rënda.

Kryesisht pasojat më të rënda janë në provincat në jug të Marakeshit, ku tashmë kanë mbetur vetëm rrënojat.

Mbreti Mohammed VI shpalli tri ditë zie kombëtare dhe urdhëroi strehim, ushqim dhe ndihmë për të mbijetuarit të

cilët e kaluan natën jashtë.

Kjo e diel shënon ditën e dytë të kërkimeve nën rrënoja, ndërsa autoritetet kanë deklaruar se numri i viktimave pritet të rritet. Tërmeti me magnitudë 6.8 i së premtes, me epiqendrë në Malet e Atlasit të Lartë, ka dëmtuar rëndë qytetin e Marakeshin, vendin e mbrojtur nga UNESCO. Fshatra të tërë janë rrafshuar totalisht, ndërsa shqetësuese mbetet ndihma në zonat provinciale, aty ku nuk dihet ende një shifër paraprake viktimash.

Mbreti i vendit urdhëroi administratën dhe ushtrinë të dhurojnë gjak, ndërsa u bëri thirrje banorëve t'i ndihmojnë spitalet të sigurojnë gjak për të



lënduarit. Lëkundjet e tokës më të rëndat që kanë prekur vendin në një shekull hodhën në tokë infrastrukturën vendase, me dëme ende të

pallogaritshme. Më shumë se 300 mijë marokenë janë prekur nga këto shkatërrime, pasi shtëpitë e tyre janë kthyer në gërmadha.

Pavarësisht prej thirrjes së vazhdueshme nga autoritetet për t'i siguruar elementët bazë për të prekurit, ata kanë deklaruar se nuk i kanë ofruar as elementët bazë si ujë dhe ushqim. OKB-ja njoftoi se është e gatshme ta ndihmojë qeverinë e Marokut, njëkohësisht të njëjtën gjë ofruan edhe ShBA-ja, Britania, Spanja, Franca dhe Izraeli.

Pas në dhënien e ndihmave nuk ka mbetur as Algeria fqinje, e cila ka pasur marrëdhënie armiqësore me Marokun në vitet e fundit, por tani po hap hapësirën e saj ajrore për fluturime humanitare në vendin e prekur nga tërmeti katastrofik.

Erdogani kërkon që Rusia të mos "margjinalizohet" në ujdinë për drithërat

STAMBOLL, 10 SHKURT - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka bërë thirrje të dielën që Rusia të mos "margjinalizohet" në bisedimet për ringjalljen e një marrëveshjeje të rëndësishme për eksportimin e drithërave ukrainase përmes Detit të Zi. "Asnjë proces që e margjinalizon Rusinë në iniciativën e Detit të Zi për drithërat nuk do të jetë i zbatueshëm", tha Erdogan për gazetarë në mbyllje të samitit të G20-s në Nju-Delhi më 10 shtator.

Ai njoftoi për një takim të ardhshëm rreth kësaj çështjeje mes përfaqësuesve nga Rusia,



Ukraina dhe Kombet e Bashkuara (OKB), pa treguar datën dhe vendin e saktë të

takimit. OKB-ja dhe Turqia e ndërmjetësuan marrëveshjen

për drithërat vitin e kaluar, e cila mundësonte kalimin e sigurt të anijeve civile përmes Detit të Zi, por ajo dështoi pasi Rusia u tërhoq në korrik. Që prej atëherë Rusia i ka sulmuar vazhdimisht portet dhe infrastrukturën e Ukrainës. Kievi i ka cilësuar këto sulme si përpjekje cinike të Rusisë për t'ia dëmtuar asaj eksportin dhe për ta minuar sigurinë e ushqimit global.

Një sulm rus me dronë të hënën e goditi një qendër të eksportit të drithërave në lumin Danub, thanë zyrtarët, duke shtuar se u dëmtuan depot dhe pajisjet bujqësore si pasojë. Pak orë më vonë, presidenti i Rusisë,

Vladimir Putin, u takua me Erdoganin në Soçi, duke dhënë shpresa se ata mund ta ringjallin marrëveshjen.

Erdogani tha pas takimit se beson se mund të gjendet një zgjidhje shumë shpejt për marrëveshjen për drithërat. "Mendoj se është e mundur të kemi përparim. Si Turqi, ne besojmë se do ta arrijmë një marrëveshje e cila do t'i përmbushë pritjet në një kohë të shkurtër", theksoi ai.

Ndërkohë, Putini tha se Rusia është e "hapur" për ta kthyer marrëveshjen e rëndësishme për eksportimin e drithërave përmes Detit të Zi.

Bideni, Modi dhe BE-ja përgatitin projekt hekurudhor dhe detar që e lidh Lindjen e Mesme me Evropën

UASHINGTON, 10 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, dhe aleatët e tij do të njoftojnë këtë të shtunë gjatë samitit të G20-s për një plan për një korridor të transportit detar dhe hekurudhor, i cili do ta lidhte Indinë me Lindjen e Mesme dhe Evropën, i cili pritet ta ndryshojë tregtinë globale.

Projekti do t'i përfshijë Shtetet e Bashkuara, Arabinë Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera në G20, tha Jon Finer, zëvendëskëshilltar për Siguri Kombëtare i Bidenit.

Bideni, kryeministri i Indisë Narendra Modi dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të njoftojnë për këtë projekt si pjesë e Partneritetit për Investime në Infrastrukturën

Globale.

Korridori i transportit detar dhe hekurudhor do të mundësonte tregti më të madhe mes vendeve, përfshirë të produkteve të energjisë.

Ai mund të jetë, po ashtu, një prej projekteve më ambicioze kundër programit masiv të Kinës për infrastrukturën, përmes të cilit ajo ka synuar t'i lidhë më shumë pjesë të botës me ekonominë e vet.

Finer i nënvizoi tri pikat kryesore të projektit. Ai tha se e para është rritja e prosperitetit që projekti do ta ofronte për vendet e përfshira në të, duke e rritur rrjedhën e energjisë dhe komunikimeve digjitale. E dyta, projekti do të ndihmonte në adresimin e mungesës së infrastrukturës së nevojshme për rritje në vendet



me të hyra të vogla dhe të mesme. Dhe e treta, Finer tha, projekti do të ndihmonte "në uljen e temperaturës" së "pasigurisë dhe trazirave" që vijnë nga Lindja e Mesme.

Von der Leyen pritet ta

përshkruajë projektin si "as më shumë e as më pak se historik", dhe si një "korridor ekonomik Indi - Lindje e Mesme - Evropë" i cili do ta përshpejtojë tregtinë mes Indisë dhe Evropës për 40 për qind, sipas një drafti të fjalimit të

përgatitur të saj.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i cili ka qenë i pranishëm vazhdimisht në samitet ndërkombëtare, përfshirë në atë të G20-s vitin e kaluar në Indonezi, qëkur Rusia e pushtoi vendin e tij para më shumë se 18 muajve, nuk u ftua nga qeveria e Mondit për tubimin e këtij viti.

Zelensky i ka përdorur tubimet e nivelit të lartë për të argumentuar për mbështetjen e vazhdueshme ekonomike dhe ushtarake për vendin e tij. India është ndër aleatët më të mëdhenj të Shteteve të Bashkuar që ka qëndruar kryesisht e heshtur rreth luftës, madje e ka rritur dukshëm blerjen e naftës ruse.

Finer tha se zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë bënë trysni për përfshirjen e Zelenskyt në samit.

Rashiqi e akuzon Serbinë për shantazh dhe i kërkon ta lirojë drejtorin e Leposaviqit

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, i bëri thirrje të dielën, siç e quajti ai, regjimit radikal të Serbisë, ta lirojë drejtorin e ri të komunës së Leposaviqit, Nikolla Radimiroviq, për të cilin tha se u arrestua më 9 shtator dhe po mbahet në Rashkë, jugperëndim të Serbisë.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha të shtunën vonë se politikani serb i Kosovës, Radimiroviq, u arrestua së bashku me të fejuarën e vet.

Nikolla është i biri i zëvendësministrit për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Radoica Radimiroviq.

Rashiqi tha më 10 shtator në një konferencë për medie në Prishtinë se "arsyeja për arrestimin e Nikollës është presioni ndaj Radoicas". "Guxoj të them se kjo është pjesë e metodologjisë së shantazheve", theksoi Rashiq. Radimiroviq u emërua drejtor i Administratës së komunës

së Leposaviqit pas zgjedhjeve të prillit në katër komunat me shumicë serbe në veri, nga të cilat dolën kryetarët shqiptarë dhe të cilat u bojkotuan dhe u kundërshtuan nga serbët - duke çuar në tensionimin e gjendjes.

Ai e përshkroi gjendjen si "më të vërtetë dramatike", duke shtuar se "është një metodologji e cila po zbatohet që 7-8 vjet, kur them aq vite, rasti im personal zgjatet kaq shumë. Sa herë jam përpjekur ta kaloj kufirin jam ndaluar [nga policia serbe] për disa orë, çdoherë. Unë zakonisht shkoj [në Serbi] për vizita familjare".

Rashiqi tregoi se Radimiroviq ishte ndaluar në pikën kufitare në Leposaviq për më shumë se tetë orë para se të dërgohej në një stacion policor në Rashkë, ku është duke u mbajtur në pritje të gjykatësit paraprak. "Ai është marrë në pyetje nga persona që prezantohen si anëtarë të BIA-s [Agjencisë për Siguri dhe Informacion të Serbisë]. Sipas informacioneve, ai do të mbahet atje deri të hënën së paku".



Rashiqi e akuzoi Qeverinë e Serbisë se po bën përpjekje për t'i kontrolluar politikanët serbë të Kosovës përmes presionit dhe shantazheve. "Kemi arritur në kulmin e një situatë ku secili prej nesh që mendon ndryshe prej regjimit radikal, ekstrem që, fatkeqësisht, e ka pushtetin në Beograd, jemi bërë cak i veprimeve të vrazhda dhe johumane", është shprehur ai. Rashiqi u emërua në postin e ministrit për Komunitete dhe

Kthim nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pasi Goran Rakiqi dha dorëheqje, së bashku me serbë të tjerë nga veriu, në nëntor të vitit të kaluar.

Rakiqi vjen nga radhët e Listës Serbe - e vetmja parti që kishte mbështetjen e Beogradit për të marrë pjesë në institucionet e Kosovës. Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, e quajti Rashiqin "llum", pasi u emërua ministër në qeverinë e Kurtit.

Arrestimi i Radimiroviqit vjen më pak se një javë para rinisjes së dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit në nivel të lartë në Bruksel.

Ministri Sveçla i kërkoi Serbisë t'i ndalë presionet dhe "aktet e jashtëligjshme ndaj shtetasve të Kosovës, veçanërisht ndaj atyre të etnisë serbe të cilët janë lojalë ndaj shtetit të tyre, Republikës së Kosovës, e në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj".

Osmani merr pjesë në takim të liderëve të rajonit në Procesin Brdo-Brione që mbahet në Shkup



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të marrë pjesë në takim vjetor të krerëve të shteteve të rajonit në kuadër të Procesit të Brdo-Brione.

Në sesionin e përbashkët me liderë të rajonit, presidentja Osmani do të mbajë fjalim, ndërkaq më pas do të zhvillojë takime bilaterale me krerët e disa shteteve pjesëmarrëse.

Takimi i Brdo-Brione është ngjarje vjetore multilaterale në të cilën takohen presidentët e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe i Sllovenisë dhe i Kroacisë, e ku fokusi kryesor është në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimin e rajonit në

BE. Temat qendrore të takimit të sivjetmë janë përshpejtimi i procesit të anëtarësimin në BE, luftimi dhe zvogëlimi i pasojave nga ndryshimet klimatike në rajon, si dhe krijimi i kushteve për qëndrimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor.

Procesi i Brdo-Brione është një nismë rajonale e bashkëthemeluar nga presidenti sloveni dhe kroat në vitin 2010.

Gjatë qëndrimit në Maqedoninë e Veriut, presidentja Osmani, krahas presidentit Stevo Pendarovski dhe atij të Shqipërisë, Bajram Begaj, do të marrë pjesë në ceremoninë e përirimit të bustit të Shën Terezës në hapësirën e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Shkup.

FSK-ja e gatshme ta ndihmojë Marokun pas tërmetit shkatërrues

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka shprehur keqardhje për situatën e shkaktuar në Marok si pasojë e tërmetit të fuqishëm, me magnitudë prej 6.8 shkallë të Rihterit, i cili shkaktoi pasojë katastrofale. "Në këto çaste të vështira për mbretin e

Marokut, Mohammed VI dhe popullin maroken lutjet tona janë me ta. Ministrit Loudiyi i shprehim gatishmërinë tonë të plotë që të ofrojmë ndihmë me të gjitha kapacitetet tona të specializuara për kërkim-shpëtim dhe rimëkëmbje në zonat e prekura. Urojmë që

numri i viktimave dhe dëmeve të jetë sa më i vogël, ndërsa familjeve të cilët kanë humbur më të dashurit e tyre u shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta. Lutemi që ta kaloni këtë sfidë të rëndë!", ka theksuar me këtë rast ministri Maqedonci.





Opozita: Kurti të raportojë në Kuvend para takimit me Vuçiqin

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë kërkuar që kryeministri Albin Kurti të raportojë në Kuvend para takimit të 14 shtatorit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Sipas opozitës, vendi është në terr informativ sa i përket ecurisë së dialogut me Serbinë. Opozita thotë se nuk pret diçka të re nga ky takim për arsye se të gjitha marrëveshjet që janë bërë në kohën e Kurtit ende nuk janë zbatuar

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë kërkuar që kryeministri Albin Kurti të raportojë në Kuvend para takimit të 14 shtatorit me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, raporton Ekonomia Online. Ato kanë theksuar se nuk presin asgjë të mirë nga ky takim, duke u nisur nga fakti që Kosova është nën masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian.

Deputetja e LDK-së, Rrezarta Krasniqi, i ka bërë thirrje kryeministrit Kurti të raportojë në Kuvendin e Kosovës para takimit me Vuçiqin, takim i cili,

sipas saj, nuk do të duhej të mbahej fare pa u zbatuar marrëveshjet që janë arritur deri më tani. "Unë pres nga kryeministri Kurti të vijë dhe të raportojë në Kuvendin e Kosovës para takimit me Vuçiqin dhe është mirë që të mos mbajë takime të tjera se duhet të zbatohen marrëveshjet të cilat i ka bërë Kurti, si ajo e Ohrit dhe ajo e Bratislavës", ka thënë deputetja e LDK-së.

Ajo ka thënë se nga ky takim nuk pret diçka të re për arsye se të gjitha marrëveshjet që janë bërë në kohën e Kurtit ende nuk janë zbatuar. "Është marrëveshja për energjinë, është marrëveshja për të

pagjeturit, ku deri më tash kemi parë që nuk ka ndodhur asgjë", ka deklaruar Krasniqi, e cila është edhe kryetare e Komisionit për Integritet Evropian. Sipas saj, deri tani vendi ka humbur shumë si pasojë e qeverisjes së Albin Kurtit, e në këtë drejtim kanë ndikuar edhe sanksionet e BE-së ndaj Kosovës. "Ne kemi humbur shumë. Përveç që kemi humbur kohë, kemi pasur edhe sanksione nga ana e Bashkimit Evropian. Shpresoj që shumë shpejt të ulen e të pajtohen për të mirën e vendit, por kryeministri e ka obligim që para takimit të vijë dhe të tregojë në Kuvendin e Kosovës

se çfarë do të diskutojë në atë takim. Për arsye se në takimin e Bratislavës, që ka qenë zëvendëskryeministri, ende nuk e dimë çfarë ka ndodhur atje", është shprehur ajo.

Edhe deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk do të duhej të shkonte në takim pa u hequr sanksionet e BE-së. Sipas tij, vendi ka shkuar në një qorrsoak pa zgjidhje. "Sa i përket Qeverisë së Kosovës, nuk duhet të shkojë në dialog në Bruksel pa u hequr sanksionet, mirëpo ja që këta nuk po mendojnë ashtu siç duhet menduar për të mirën e vendit dhe do të jenë në tavolinë me Vuçiqin. Unë nuk pres nga ky takim diçka pozitive. Janë qëndrime të kundërta dhe Vuçiqi pretendon apo kërkon që të implementohet asociacioni me kompetenca ekzekutive. Ndërsa qeveria me të drejtë kërkon njohjen nga Serbia, paraprakisht para se të implementohet asociacioni. Kështu që, me një fjalë, kemi

hyrë në një qorrsoak të dialogut dhe unë nuk shoh ndonjë zgjidhje", ka thënë ai.

Ai ka thënë se vendi është në një terr informativ sa i përket raportimeve të qeverisë në lidhje me dialogun me Serbinë. E, sipas tij, Kurti duhet të raportojë paraprakisht për qëndrimet e tij në raport me dialogun në Bruksel. "Sa i përket raportimit të kryeministrit të Kosovës dhe qeverisë në përgjithësi, mendoj se jemi në një terr informativ. Asnjëherë nuk ka ardhur paraprakisht të raportojë para deputetëve në Kuvendin e Kosovës dhe kështu që e ka marrë si pronësi Kosovën të vetën dhe kjo po shkakton shumë telashe. Patjetër duhet të raportojë paraprakisht për qëndrimin e vet në Bruksel, për hapat që do t'i ndërmarrë, për mospajtimet, për të gjitha ato që duhet të mbrohen, edhe shteti edhe sovraniteti, edhe ajo që ai çdoherë po thotë ne po e shtrijmë sovranitetin, ja që kemi të kundërtën", ka thënë Lekaj.

Bumi turistik në Shqipëri: Njerëzit janë shumë miqësorë

TIRANË, 10 SHTATOR - Media ndërkombëtare, të tilla si CNN, raportuan për Shqipërinë, duke e renditur si një ndër destinacionet më interesante të këtij sezoni veror qoftë për plazhet, zonat malore, ushqimet apo edhe çmimet e volitshme. Të dhënat e fundit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë ato për muajin gusht, të cilat tregojnë se Shqipërinë e vizituan mbi dy milionë turistë të huaj, ose 18 % më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa prej janarit e deri në fund të gushtit e vizituan gati 7.2 milionë, apo 27 % më shumë se në periudhën janar-gusht vitin e kaluar.

Në rrugët e Tiranës shihen çdo ditë grupe turistësh.

Hasan Luozani është një prej tyre, i cili thotë se për Shqipërinë ka dëgjuar nga mediet, ndaj ka vendosur ta vizitojë. "Vij nga Algjeria. Kjo është hera e parë që jam në Tiranë dhe më pëlqen. Njerëzit janë shumë pozitivë dhe të ndihmojnë. Ndihem sikur jam në vendin tim", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Çifti Labba vjen nga Gjermania. Thotë se ka vizituar disa qytete në veriun e Shqipërisë, do të qëndrojë disa ditë në Tiranë dhe më pas do të udhëtojë drejt

jugut. "Kemi vizituar Shkodrën, Dibrën, tani Tiranën. Na ka pëlqyer gjithçka, natyra, njerëzit, gjërat e vjetra dhe ato moderne. Njerëzit janë shumë miqësorë. Kjo na ka pëlqyer më së shumti, ndërsa problem janë rrugët, nuk janë të mira, janë të ngushta. Duhet të udhëtoni me shumë kujdes", thotë çifti gjerman.

Mes grupeve të turistëve në qendër të kryeqytetit shqiptar është edhe një i ri nga Anglia. "Sapo kam ardhur. Po vizitoj Tiranën, më pas do të udhëtoj drejt plazheve të jugut. Më pëlqen Tirana. Është e bukur. Ushqimin tradicional nuk e kam provuar ende, pasi kam blerë ushqime në supermarket", thotë Woody Newhouse.

Jordan Stacey vjen nga Melburni i Australisë dhe gjendet në Shqipëri tash e gati një muaj. "Kam vizituar Shkodrën, Tiranën, Beratin, Vlorën, Himarën. Kam qenë në Theth për 'hiking'. Ishte një natyrë fantastike. Ishte e bukur bujtina ku qëndrova, ushqimi i shijshëm. Gjithashtu, njerëzit janë shumë miqësorë dhe të ndihmojnë nëse ke problem", thotë Jordan, për herë të parë vizitore në Shqipëri.

Por, ajo thotë se ka hasur edhe në disa probleme. "Ishte një përvojë

shumë e bukur, por një problem i madh ishte mungesa e sinjalistikës, e tabelave orientuese, e këshillave në zonat që paraqesin rrezik për shkak të terrenit të vështirë. Një tjetër problem ishte transporti publik, mungesa e tabelave për oraret e nisjes. Mund ta mësoje vetëm duke pyetur njerëzit, por ishte e vështirë pasi shumica nuk dinin anglisht", thotë vajza australiane. Ajo shpreh disa rezerva edhe për cilësinë e shërbimit në restorante, për vonesat në marrjen e porosive apo dorëzimin e tyre, si dhe për kryerjen e pagesave.

A do të ruhet bumi turistik?

Bruno Ismaili, udhërrëfyes turistik, shoqëron grupet e turistëve në qendër të Tiranës. "Punoj prej vitesh kryesisht me turistë që flasin gjuhën gjermane, bëjmë udhëtime turistike, malore, ecje dhe arkeologji. Ky bum na gjeti pa u përgatitur. Pavarësisht se shumë turistë dalin të kënaqur, jemi të papërgatitur". "E para është shërbimi - nuk e ka cilësinë e duhur, mungon fuqia punëtore, mungon pastërtia. Ka vende ku

Rama: Shqipëria 'u pushtua' nga turistët e huaj

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se Shqipëria ka hyrë në një fazë të re sa i përket turizmit. Në fjalimin që mbajti pak ditë më parë në Asamblenë e Partisë së tij Socialiste, Rama tha se Shqipëria këtë sezon "u pushtua" nga turistët e huaj. "Shqipëria duhet të bëhet vendi evropian i denjë për bukuritë që i ka falur Zoti. Turizmi masiv i ka sjellë vendit shumë të ardhura, por duhet t'i synojmë majat e industrisë turistike botërore. Nami i mirë që kemi marrë sot, mund të na kthehet në bumerang nëse nuk përgatitemi", tha kryeministri shqiptar.

ndotja e mjedisit është shumë e madhe. Për shembull, po të shkosh në Liqenin e Komanit është shumë pisët", thotë Ismaili për "Radion Evropa e Lirë". Pavarësisht prej këtyre problemeve, ai beson se turistët, kryesisht të rinjtë, do të rikthehen dhe se trendi i bumit turistik do të ruhet. "Në mediet gjermanishtfolëse po bëhet një reklamë e paparë për Shqipërinë. Të rinjtë besoj se do të rikthehen. Ka që kanë parë veriun dhe jugun dhe duan të shohin edhe vende të tjera", thotë Ismaili.

Edhe Riges Beqiri, ekspert i turizmit në Shqipëri, beson se kjo ecuri pozitive e turizmit do të ruhet dhe se turistët do të rikthehen edhe vitin tjetër. "Gjithmonë ka turistë që u rikthehen vendeve që kanë vizituar më parë. Një arsye është përvoja e mirë që kanë pasur. Një tjetër arsye janë çmimet më të mira apo destinacionet e reja që nuk ofroheshin më parë", thotë Beqiri, duke theksuar nevojën edhe për një bashkëpunim më të mirë mes institucioneve të shtetit dhe operatorëve turistikë për promovimin e Shqipërisë.



Autobusët e trafikut urban së shpejti me wi-fi

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se autobusët e Trafikut Urban do të pajisen me Wi-fi. Në "Facebook", Rama ka bërë me dije kjo do të

ndodhë shumë shpejt. Ai ka theksuar se udhëtarët që përdorin autobusët e Trafikut Urban do të mund ta bëjnë pagesën e biletës edhe përmes SMS. "Shumë shpejt autobusët e Trafikut

Urban Prishtinë do të pajisen me wi-fi. Udhëtarët, po ashtu, do të mund ta bëjnë pagesën e biletës me sms përmes operatorëve telefonikë 'Vala' dhe 'Ipko', ka shkruar Rama.



Policia sekuestron disa mjete ushtarake në një shtëpi në Leposaviq

Leposaviq, 10 shtator - Policia e Kosovës ka sekuestruar disa mjete ushtarake në Leposaviq. Policia ka njoftuar se mjetet ushtarake të sekuestruara janë një helmë ushtarake, dy pllaka antiplumb, tre këllëf të pistoletës dhe një sprej. Siç njofton policia, mjetet ushtarake janë gjetur në shtëpinë e një të dyshuari

kosovar, i cili ishte arrestuar më herët. "Njësia e Hetuesisë gjatë kontrollit të shtëpisë së të dyshuarit kosovar, që ishte arrestuar më herët, ka gjetur dhe sekuestruar një helmë ushtarake, dy pllaka antiplumb, tre këllëf të pistoletës dhe një sprej", thuhet në njoftim. Rasti është duke u hetuar.



Për gjashtë muaj AIP shqiptoi tetë gjoba



Prishtinë, 10 shtator - Fushë-Kosova, Gjilani e Shtërpca janë komunat e Kosovës ndaj të cilave Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka shqiptuar gjoba këtë vit për mosofrim të qasjes në dokumente publike. Për të njëjtën arsye, janë gjobitur edhe Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Infrastrukturës.

Dy gjoba janë shqiptuar për moszbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Krenare Sogojeva-Dermaku, komisionare e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, ka

thënë për "Ekonomia Online" se ankesat kanë të bëjnë për mohim të qasjes në dokumente publike dhe në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. "Në fakt numri i gjobave deri më sot, sa i përket qasjes në dokumente publike, është 8, 4 prej tyre janë ndaj komunës së Fushë-Kosovës, një ndaj Universitetit të Prishtinës, respektivisht Fakultetit të Mjekësisë, një ndaj komunës së Shtërpçës, një ndaj komunës së Gjilanit dhe gjoba e fundit është ndaj Ministrisë së Infrastrukturës", u shpreh Sogojeva. Krahas kësaj, Sogojeva-

Dermaku ka thënë se institucioni që ajo e drejton këtë vit ka dënuar edhe një biznes dhe Partinë Socialdemokrate për moszbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo e fundit është gjobitur në rastin ku në oborrin e qeverisë shpalosi peticionin e vitit 2015 kundër Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, me 205 mijë nënshkrime të qytetarëve. E sa i përket numri total të ankesave për këtë periudhë kohore janë 243, ku 257 prej janë mbyllur, ndërsa pjesa tjetër është në shqyrtim.

Drejtoresha e Arsimit në Mitrovicë: 38 % e nxënësve nuk kanë tekste shkollore

MITROVICË, 10 SHTATOR - Drejtoresha e Arsimit në komunën e Mitrovicës, Drita Kadriu, ka thënë se rreth 38 % e nxënësve nuk kanë tekste shkollore. Në "Facebook" ajo ka bërë me dije se mësimdhënësit nuk duhet t'i dënojnë nxënësit që nuk kanë tekste shkollore. "Të dhënat e mbledhura nga shkollat, (përfshirë 6 shkollat), tregojnë se 38 % të nxënësve nga klasat 1-5 ende nuk janë pajisur me tekste shkollore. Mësimdhënësit, mos i



dënoni nxënësit (me ndenjtë në një këmbë) për mungesë tekstesh", ka shkruar Kadriu.

Përfundoi edicioni i katërt i "Autostradës Biennale"

PRIZREN, 10 SHTATOR - Edicioni i katërt i "Autostradës Biennale" ka përfunduar pas dy muajve të ekspozitave në hapësira të ndryshme të Prizrenit, të cilat e shndërruan qytetin në muze të hapur për artdashësit. "Ekspozita përfundoi, por jo edhe ndikimi i këtij organizimi ndërkombëtar, pasi qyteti ka treguar interes për ta mbajtur njërin nga veprat e instaluar



në qendër të qytetit edhe pas përfundimit të këtij edicioni", ka njoftuar komuna e Prizrenit.

Nis asfaltimi i rrugës "Ukshin Hoti", do të ketë katër korsi

Prishtinë, 10 shtator - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama,

ka bërë me dije se është duke u asfaltuar rruga "Ukshin Hoti", e cila do të ketë katër

korsi, trotuare më të gjera dhe gjelbërim. "Lirum hapësirën publike në këtë

zonë dhe tani po ua kthejmë qytetarëve", ka shkruar Rama në "Facebook".



Dimër stabil me rrymë, por me çmime të paparashikueshme

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Pas dy vjetësh të paqëndrueshëm me rrymë, me rritje çmimesh e me thirrje për kursim, Kompania për Distribucionin e Energjisë Elektrike (KEDS) garanton për këtë dimër furnizim stabil. Për këtë qëllim, KEDS-i ka bërë investime në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike. "Investimet e realizuara garantojnë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për të gjithë", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Lulzim Krasniqi, zëdhënës në këtë kompani.

Pushtimi i Ukrainës nga Rusia - një ndër eksportueset më të mëdha të gazit natyror - ka ndikuar në furnizimin me energji gjetiu në botë, sidomos në vitin që ka nisur, më 2022. Për rrjedhojë ka pasur mungesa të rrymës dhe rritje çmimesh.

Kosova nuk arrin t'i plotësojë nevojat e mbi 1.7 milion banorëve të saj me rrymë, andaj edhe importon nga bursat e huaja.

Cilat janë kapacitetet e Kosovës?

Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Një nga arsytet për nënprodhim është vjetërsia me dekada e termocentraleve. Në një deklaratë dhënë "Radios Evropa e Lirë", Korporata Energjetike e Kosovës, e cila është



përgjegjëse për prodhimin e energjisë elektrike, tha se aktualisht ka në operim njësitë A-3 dhe A-4 të Termocentralit Kosova A si dhe njësinë B-2 të Termocentralit Kosova B, me kapacitet prej rreth 500 megavatesh. KEK-u tha se gjatë sezonit dimëror pritet të ketë në operim njësi shtesë, me kapacitet prej rreth 760 deri në 800 megavate. "Megjithatë, asnjëherë nuk mund të përjashtohet fakti se njësitë tona gjeneruese janë të vjetruara dhe nuk garantojnë 100 për qind operim të sigurt, që do të thotë se edhe mund të kemi ndonjë ndërprerje të prodhimit të paplanifikuar, por jo më gjatë

se 72 orë", tha KEK-u.

Vitin e kaluar, sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), janë importuar mbi 750 mijë megavate energji elektrike, ndërsa nga termocentralet e Korporatës Energjetike të Kosovës janë prodhuar rreth 6.35 milionë megavate.

Çmimi i energjisë elektrike në bursën hungareze HUPX, nga importon Kosova, ka qenë 91 euro për megavat më 9 shtator. Për krahasim, në gusht të vitit të kaluar ka shkruar deri në rreth 430 euro për megavat, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2021 ka qenë rreth 150 euro.

Në KEDS thonë se nevojat për

import do të vazhdojnë edhe këtë dimër dhe se çmimet në bursat ndërkombëtare "do të jenë të paparashikueshme". "Se a do të ketë rritje ose jo të çmimit të energjisë elektrike, kjo nuk varet nga ne, por nga tregu dhe shumë faktorë të tjerë. Mund të themi që pasiguritë rreth furnizimit me gaz natyror të Evropës vazhdojnë...", thotë zëdhënësi i KEDS-it, Krasniqi.

Çmimet

Vitin e kaluar çmimi mestar i rrymës për kategorinë e konsumatorëve familjarë ka shkruar në 6.14 euro për kilovat -

nga 5.60 euro sa ka qenë në vitin 2021, ndërsa për konsumatorët jofamiljarë çmimi mesatar i rrymës në vitin 2021 ka qenë 8.39 euro, për të shkruar në 9.27 euro në vitin 2022.

Në prill të këtij viti çmimi është rritur sërish - për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Krasniqi thotë se kursimi i rrymës dhe shfrytëzimi racional i saj do të kërkohen edhe gjatë këtij dimri.

Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat e sektorit të energjisë kanë kërkuar vazhdimisht nga qytetarët të kursejnë.

Për qëllim kursimi, në gusht janë subvencionuar mbi 2 000 familje për izolimin e shtëpive. Projekti prej 10 milionë eurosh është mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe është zbatuar nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Më 5 shtator Qeveria e Kosovës ka lansuar, po ashtu, programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm, të cilët do të subvencionohen për pagesën e faturave të energjisë elektrike. Në këtë kategori janë përfshirë: personat me aftësi të kufizuara, prindërit vetushqyes dhe pensionistët që jetojnë vetëm. "Nëse një familje ka katër anëtarë dhe i ka më pak se 600 euro të ardhura mujore mesatare, mund të kualifikohet për programin", ka thënë ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Programi në fjalë do të jetë njëvjeçar.

Rriten çmimet e perimeve në Prishtinë, ankohen qytetarët

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Në Tregun e Gjellbër në kryeqytetin e Kosovës çmimet e prodhimeve bujqësore vendore janë ngritur dukshëm këto ditë.

Konsumatorët ankohen se këto çmime janë të larta dhe të përballeshme për shumë qytetarë. Në anën tjetër, tregtarët shprehën se rritja e çmimeve ka ndikuar shkaku i mungesës së perimeve në këtë vit dhe kërkesës nga blerësit.

Sherife Vrella, pensioniste e cila kishte dalë në treg për furnizim me perime, thotë se çmimet e tyre nuk janë të përballeshme. Vrella shton se çmimet janë të larta dhe, sipas saj, me pensionin që e merr në muaj e ka të vështirë të mbijetojë. "Nuk është e mirë për askënd, as për konsumatorin as për blerësin. Nuk kemi çfarë të bëjmë, me këto mjete, me këto pensione, duhet mbijetuar, se ne shqiptarët në rend të parë kemi specat dhe perimet", shtoi Vrella. Për ngritjen e çmimeve të perimeve, konsumatori Ekrem Ismajli ka fajësuar institucionet e shtetit. Sipas tij, shteti po u

mundëson tregtarëve t'i ngritin çmimet si të duan. Ky blerës nga Prishtina ka thënë se mungesa e importit të perimeve ua jep mundësinë edhe bujqve t'i ngritin çmimet. "Janë duke u ngritur çmimet. Prodhuesit vendorë nuk po punojnë, ndihmë nga shteti nuk kanë. Nuk është vendim i mirë. qysh me qenë vendim i mirë, shteti po punon shumë pak për bujqit. Duhet të punojë më shumë. Të ardhurat janë të vogla. Tregtarët po e shfrytëzojnë rastin, kur nuk ka import, tregtarët po ngritin çmimet, kështu edhe këta i kanë fajet pak, edhe shteti", tha Ismajli.

Ndërkaq shitësi i perimeve Beqir Avdiu tha se kërkesa nga konsumatorët për të blerë perime është shumë e madhe, ndërsa shton se kanë shumë ankesa për çmimin e tyre.

Kurse fermeri Enver Konjuhi, që ka dalë në treg për t'i shitur prodhimet bujqësore, tha se çmimi vendoset në bazë të konsumatorëve, derisa thekson se subvencionet po i ndihmojnë shumë.



Shitësi Avdiu tha se prodhuesit e perimeve kanë mungesë të këtyre produkteve nga të mbjellat e fundit dhe për këtë arsye çmimi i perimeve është ngritur. "Ka sasi, por jo aq shumë. Ka qenë shkaktare pak klima. Këtë pranverë ka pasur reshje të mëdha, e për arsye

bujqit është dashur t'i mbjellin perimet dy-tri herë për t'i plasuar në treg në kohën e turshive. Kështu që, ka pasur vështirësi. Ata nuk kanë pasur prodhime dhe për këtë edhe çmimi është më i lartë. Ka prodhues që ia ka dëmtuar shiu krejt të mbjellat dhe nëse i ka

pasur tre hektarë, tash nuk i ka as gjysmën e tyre", tha Avdiu.

Edhe në raportin e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të publikuar dy ditë më për është thënë se çmimi i perimeve është ngritur 28 për qind, e i atyre për pemë 11.4 për qind. (kp)

Oppenheimer: Historia e vërtetë e babait të Bombës Atomike

PROMETEU I RI


Ai që njihet si “babai i bombës atomike”, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u bë një shkencëtar i persekutuar, si Galileo (nuk është rastësi që Bertolt Brecht u frymëzua nga historia e tij për të rishkruar dramën “Jeta e Galileos”). Në të vërtetë, më saktë, sipas Kai Bird dhe Martin Sherwin, fitues të çmimit Pulitzer për esenë Prometeu Amerikan: Triumfi dhe Tragjedia e J. Robert Oppenheimer, mbi të cilin bazohet filmi i Christopher Nolan në kinema, Oppenheimer ishte një Prometeu i ri: domethënë dikush që, ashtu si heroi i mitologjisë greke, u dënua se u dha zjarr njerëzve, e pagoi se i dha njerëzimit një shpikje që do të ndryshonte rrjedhën e historisë.

I lindur në prill të vitit 1904 në Nju Jork në një familje gjermane me origjinë hebreje, Roberti që në moshë të re u shqua për inteligjencën dhe interesat e tij, nga shkenca te poezia, nga gjuhët e huaja (ai mësoi gjashtë, përfshirë sanskritishten) te mineralogjia. U bë aq i aftë sa u pranua në Klubin Mineralogjik të Nju Jorkut në moshën 12-vjeçare. Në vitin 1925 ai mori një diplomë në fizikë nga Harvard, e ndjekur nga një doktoraturë në Göttingen (Gjermani) në 1927. Oppenheimer u kthye në SHBA në vitin 1929, pasi ishte dëshmitar i rritjes së Hitlerit në Evropë – por edhe rrënimin që u solli amerikanëve nga Depresioni i Madh – ai u miqësua me disa anëtarë aktivë të Partisë Komuniste, si Katherine “Kitty” Puening, një studente radikale e Berkeley, e cila do të bëhej gruaja e tij në vitin 1940.

ARITMETIKE E TMERRSHME

Para dasmës, në laboratorin e fizikës në Berkeley, Oppenheimer bashkëpunoi me Ernest Lawrence, shpikësi i ciklotronit, fitues i çmimit Nobel në vitin 1939. Në të njëjtin vit, ditën kur Hitleri pushtoi Poloninë duke filluar Luftën e Dytë Botërore, Oppenheimer dhe kolegu Hartland Snyder botuan atë që fizikani dhe historiani i shkencës Jeremy Bernstein do ta quante “një nga punimet më të mëdha në fizikë të shekullit të njëzetë”.

Në të, dy autorët ngrinin pyetjen se çfarë do të ndodhte me një yll masiv që kishte filluar të konsumohej, pasi kishte shteruar karburanti: duke u bazuar në teorinë e relativitetit të përgjithshëm të Ajnshtajnit, ata argumentuan se ai do të shtypej nga një “singularitet” i tillë që as edhe valët e dritës nuk do të kishin mundur t’i shpëtonin tërheqjes së gravitetit të tij. Studimi hodhi themelet për



teorinë e vrimave të zeza, e cila, megjithatë, u formulua plotësisht vetëm tridhjetë vjet më vonë. Sidoqoftë, duhet thënë se artikujt e shkruar nga Oppenheimer ishin të vështirë për t’u kuptuar edhe për ekspertët: ai përdorte formula komplekse matematikore për të demonstruar parimet fizike, por ndonjëherë bënte gabime, ndoshta për shkak të nxitimit. “Fizika e tij ishte e mirë,” komentoi një herë bashkëautori i tij Snyder, “por aritmetika e tij ishte e tmerrshme.”

PROJEKTI MANHATTAN

Pas pushtimit të Polonisë, Albert Einstein, Leó Szilárd dhe fizikantë të tjerë që emigruan në Shtetet e Bashkuara i shkruan një letër Presidentit Roosevelt duke e paralajmëruar atë se Gjermania mund të zhvillonte bomba atomike, si dhe duke sugjeruar që Shtetet e Bashkuara duhet t’i paraprinin. Oppenheimer u zgjodh nga generali Leslie R. Groves për të udhëhequr përpjekjen për të fituar këtë garë. Ishte i ashtuquajtur i Projekti Manhattan, që mori emrin e vendndodhjes së zyreve të Distriktit të Inxhinierëve të Manhattanit, i krijuar në vitin 1942.

EKIPI I ËNDRRAVE

Si drejtor shkencor i laboratorit, misioni i parë i “Oppie” ishte të rekrutonte mendjet më të shkëlqyera në vend: Frank Biondi, Arthur Compton, Harold Urey, Enrico Fermi, Ernest Lawrence, Glenn Seaborg, Edwin McMillan, Emilio Segrè, Owen Chamberlain, Eugene Wigner, Schwinger, Richard Feynman, Hans Bethe, Luis Álvarez, James Rainwater, John van Vleck, Val Fitsch, William Fowler dhe

Norman Ramsey (për të përmendur vetëm laureatët e Nobelit). Qëllimi i dytë ishte krijimi i një bombe atomike. Bazuar në studimet e kryera deri atëherë, dukej se kishte dy mënyra të mundshme: përdorimi i uraniumit ose i plutoniumit.

TESTI BËRTHAMOR

Ekipi i Projektit Manhattan ndërtoi prototipe të dy llojeve të bombave, të cilat do të çonin në ndërtimin e “Little Boy”, një pajisje uraniumi e shpërthyer mbi Hiroshima dhe “Fat Man”, një bombë plutoniumi me metodën e shpërthimit, e cila u hodh mbi Nagasaki. Meqenëse kjo lloj arme ishte e paprecedentë, Oppenheimer e ndjeu të nevojshme të eksperimentonte me të. Prandaj, më 16 korrik 1945, në shkretëtirën Alamogordos, afër Los Alamos, Nju Meksiko, u krye i ashtuquajtur Testi i Trinitetit, me një bombë plutoniumi (“The Gadget”).

Shpërthimi lëshoi energjinë prej 21,000 tonësh TNT dhe nxehtësia e tij ishte aq intensive sa shkriu rërën në zonën përreth, duke krijuar një lloj xhami jeshil pak radioaktiv të quajtur “trinitit”.

DILEMA ETIKE

Sipas dëshmive të ndryshme, pasi ishte dëshmitar i shpërthimit, Oppenheimer citoi një tekst të shenjtë indian, me këto fjalë: “Tani jam bërë Vdekja, shkatërruesi i botëve”. Disa nga shkencëtarët që dëshmuan shpërthimin, duke përfshirë edhe atë vetë, argumentuan në favor të një shpërthimi që demonstronte fuqinë e bombës dhe që do të bënte që armiku të dorëzohej, pa e përdorur atë mbi civilët.

Ata nuk u dëgjuan, por pas bombardimeve atomike të Japonisë (rreth 200,000 të vdekur menjëherë, si dhe shumë të tjerë më vonë, për shkak të rrezatimit), ata punuan për të siguruar që armë të tilla shkatërruese të mos përdroreshin më. Në vitin 1945, në Saturday Review of Literature, Oppie shkroi se armët bërthamore ishin instrumente “agresioni, befasie dhe terrori” dhe shprehja atomike e “çnjerezimit dhe ligësisë së luftës moderne”. Megjithatë, gara e armëve atomike sapo kishte filluar.

NË SHËNJESTËR TË FBI-SË

Për disa kohë, në fakt, fizikani me origjinë hungareze Edward Teller kishte punuar për një armë edhe më shkatërruese: bombën me hidrogjen. Oppenheimer u ftua të bashkohej me projektin, por nuk pranoi. Nga viti 1947 deri në 1952, fizikani drejtoi Komitetin e Përgjithshëm Këshillues të Komisionit të Energjisë Atomike të Shteteve të Bashkuara, duke kaluar kohën për arritjen e një marrëveshje ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve bërthamore: “Nëse armët atomike bëhen pjesë e arsenalit të kombeve, do të vijë koha kur njerëzimi do të mallkojë emrat e Los Alamos dhe Hiroshima. Popujt e botës duhet të bashkohen ose do të humbasin të gjithë”, tha ai.

GJUETI SHTRIGASH

Ky aktivitet “pacifist” e vendosi atë në shënjestrën e senatorit Joseph McCarthy, krijuesit të një gjuetie shtrigash që synonte spastrimin e Shteteve të Bashkuara nga spektri i komunizmit. Duke u bazuar në

dokumentet e vjetra të FBI-së që dokumentonin simpatitë e fizikanit për qarqet antifashiste, në refuzimin e tij për të bashkëpunuar në krijimin e bombës me hidrogjen dhe në dëshminë e pafavorshme të Teller-it, komisioni hetimor e akuzoi shkencëtarin se ishte komunist dhe se kishte kaluar sekrete të bombës tek sovjetikët.

AKUZAT

Nga ana e tij, Oppenheimer nuk i prit mirë marrjet në pyetje: në tetor 1945 ai u soll aq keq në zyrën e Presidentit Harry Truman sa u quajt “shkencëtari qaraman”. Në realitet nuk kishte prova të vërteta. Siç shpjegon Kai Bird, “shumë nga provat në arkivat e FBI-së ishin kontradiktore. Ndërsa disa nga informatorët pohuan se Oppenheimer ishte komunist, të tjerët e mohuan atë”.

Në çdo rast, në vitin 1954 fizikanit iu mohua hyrja në Komisionin e Energjisë Atomike “për arsye të sigurisë kombëtare”. Më pas, komuniteti shkencor u ngrit, duke arritur, brenda pak muajsh, ta konfirmonte atë në postin e drejtorit të Institutit për Studime të Avancuara në Princeton, të cilin e mbajti deri kur vdiq, në vitin 1967 për shkak të kancerit në fyt.

REHABILITIMI I VONUAR

Disa vite më herët, në vitin 1963, Presidenti Lyndon Johnson i kishte dhënë atij çmimin Enrico Fermi për një “rehabilitim” zyrtar. Por vetëm 55 vjet pas vdekjes së Oppie, pra në dhjetor 2022, sekretarja e Departamentit të Energjisë të qeverisë së Bidenit, Jennifer Granholm, deklaroi se vendimi i vitit 1954 ishte rezultat i një procesi “që kishte të meta: me kalimin e viteve, janë shfaqur prova rreth “paragjykitimit” dhe “pasaktësisë” së hetimit të Oppenheimerit, ndërsa në të njëjtën kohë “dëshmitë e besnikërisë dhe dashurisë së tij” për Shtetet e Bashkuara janë forcur më tej.”

Sprova e Oppenheimer-it u dëshmoi shkencëtarëve, siç ka shkruar sociologu Daniel Bell, “se ata nuk mund të mos pajtoheshin më me politikën e qeverisë. Që atëherë ka mbizotëruar një pikëpamje se si shkencëtarët duhet t’i shërbejnë vendit të tyre.” Megjithatë, atyre që e pyetën Oppenheimerin në vitet e tij të fundit nëse donte të ndryshonte diçka nga e kaluara e tij, fizikani u përgjigj: “Unë bëra detyrën time, që ishte të bëja punën që duhej të bëja. Në Los Alamos nuk isha në një pozicion për të marrë vendime, do të kisha bërë gjithçka që do të më kërkonin, qoftë edhe një bombë në një formë tjetër, nëse do të mendoja se ishte teknikisht e mundur.” / Focus – Bota.al

1991 | Metallica, Nirvana, Guns'n'Roses dhe viti që ndryshoi Rock-un



Nëse rroku i viteve '90 kishte një vit-flamur, ai ishte 1991. Viti kishte nisur me Operation Desert Storm në Irak dhe Luftën e Parë të Gjirit, por një "bombardim" jo më pak i rëndësishëm ndodhi disa muaj më vonë. Brenda vetëm 7 javëve, nga mesi i gushtit deri në fillim të tetorit, një seri albumesh dolën në treg, të cilët do të bëheshin jo vetëm më të shiturit e atij viti, por edhe do i jepnin formë dekadës së ardhshme. Ata ishin "Black Album" i Metallica, "Nevermind" i Nirvana, "Use Your Illusion I" i Guns'n'Roses, "Ten" i Pearl Jam dhe "Blood Sugar Sex Magic", i Red Hot Chili Peppers. Të gjithë bashkë, sollën një epokë të re në historinë e rock-ut, të ngjashme me epokën e artë të viteve shtatëdhjetë.

Në fakt, gjërat kishin nevojë për një shkundje të fortë. Hard Rock-u i modës së vjetër po kapej fort pas "karrikes" së vet. Grupet e preferuar të të ashtuquajturve baby boomers, si Van Halen, Bryan Adams, Ozzy Osbourne dhe Scorpions ishin në të gjithë klasifikimet. "Extreme", një grup funk rock-u nga Bostoni bëri bujë me baladën akustike "More than words", ndërkohë që grupi nga New Jersey, Skid Row u ngjiten në vendin e parë me albumin e

tyre të dytë, "Slave to the Grind". Kënga më e dëgjuar e vitit ishte "Bohemian Rhapsody" e Queen. Ishte realizuar në 1976, por ishte rikthyer në skenë pas vdekjes së Freddie Mercury. Dukej sikur, sa më shumë që gjërat ndryshonin, aq më shumë ato mbeteshin njësoj. Por, shumë shpejt një përmbysje do të ndodhte në shumë fronte.

Metallica dhe sidomos Guns'n'Roses ishin tashmë grupe që kishin sjellë hit-e të mëdha, dhe prapa tyre kishin kompani diskografike me peshë.

Askush nuk u befasua prej suksesit të tyre. Po kështu, The Red Hot Chili Peppers, kishin ndërtuar një bazë fansash që në mesin e dekadës paraardhëse, pasi kishin lënë pas varësinë nga droga dhe vdekjen e ish kitaristit, Hillel Slovak.

Por, ajo që po ziente në të vërtetë ishte skena e muzikës Grunge. Pearl Jam, Soundgarden dhe grupi nga Chicago, The Smashing Pumpkins, ishin në pararojë të kësaj lëvizjeje të re. E megjithatë, ishte albumi i dytë i një grupi me tre 20 e ca vjeçarë

sarkastikë, që e futi në të vërtetë në hartë muzikën grunge dhe qytetin e Seattle.

Pak njerëz do kishin vënë bast që Nirvana do të bëheshin një prej grupeve më të mira të dekadës, edhe pasi ata kaluan tek kompania diskografike DGC Records. Por kënga e tyre e parë, një hit i mbushur me sarkazmë i quajtur "Smells like teen spirit", u ngjit menjëherë në majat e hiteve të MTV dhe radiove. Albumi ku ajo bënte pjesë, Nevermind u ngjit dhe ai në majë të renditjeve të të gjithë

botës, pas daljes në 24 shtator 1991.

Eshtë e kollajtë të harrosh sot, se shumë gjëra kishin ndodhur në të dy skajet e muzikës. Muzika alternative po futej në radarë me inaugurimin e festivalit të Lollapalooza në korrik, i cili shumë shpejt u bë një histori suksesi befasuese. Kjo edhe falë një serie grupesh si Jane's Addiction, Siouxsie and the Banshees, Living Colour, Ice-T et.

Gjëra interesante po ndodhnin edhe në skajet e muzikës metal, nga heronjtë brazilianë Sepultura me albumin e tyre Arise deri tek disa të pakënaqur norvegjezë që digjnin kisiha dhe që hodhën themelet e skenës së black metal.

Por të gjitha këto nuk ishin asgjë, në krahasim me shkundjen e madhe që ndodhi në ato shtatë javë të lavdishme në fundin e verës dhe fillimin e vjeshtës. Në fund të vitit, Metallica ua kishin kaluar në shitje albumesh, por Nirvana ishin bërë flamuri përreth të cilit një brez i ri muzikantësh dhe fansash po mblidheshin me shpejtësi. Ndryshimi kishte ardhur, dhe fiks në momentin e duhur. / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kurti tregon për përfitimet që do t'i ketë Kosova me Lojërat Mesdhetare 2030

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka shkruar se nga Heraklioni i Greqisë për në Prishtinë po kthehen me kujtime të

mira, përgjegjësi të reja, e plane të shumta investive, pasi Lojërat Mesdhetare 2030 po i sjellin në Kosovë. Kurti ka postuar një video në "Facebook", ku edhe ka

shkruar se 7 vjet përgatitje dhe mbi 250 milionë euro investime publike, për t'u bërë nikoqir i 26 shteteve pjesëmarrëse e 23 disiplinave sportive.

"Mijëra atletëve e dhjetëra mijëra turistëve, në ngjarjen më të madhe të sportit në historinë e vendit. Na priftë e mbara", ka shkruar Kurti.



Shqipëria 'fundos' Poloninë, 'Euro 2024' edhe më afër

TI Ranë, 10 SHTATOR - Shqipëria ka shënuar një fitore të madhe 2-0 në "Air Albania" ndaj Polonisë, në ndeshjen e vlefshme për grupin e të kualifikueseve të "Euro 2024". Në mesin e pjesës së parë, polakët festuan pasi Kiwior realizoi gol, pas zhvillimit të një goditje standarte, me topin që me fat mbeti në këmbët e mbrojtësit 23-vjeçar. Gjithsesi, pas një kontrolli nga VAR, goli u anulua për "offside". Në minutën e 38-të, Jasir Asani do koordinohet në mënyrë perfekte për të realizuar një gol të rrallë nga distanca. Një gol që shumë nga yjet e futbollit botëror do e kishin zili, një gol që mund të vlejë shumë në rrugët e gjatë drejt kualifikimit. Trajneri i kuqezinjve, Sylvinho godet me zëvendësimet në pjesën e dytë, teksa aktivizon Dakun në minutën e 60-të dhe sulmuesi nuk

pret shumë, duke dyfishuar menjëherë shifrat, ndërsa shpërtheu në lot gëzimi vetëm pas pak sekondash. Gjithçka erdhi pasi kontrollloi si duhet një top në afërsi të zonës, e në të tilla raste nuk mund të falte. Lewandowski e pati të pamundur të bënte diçka në këtë takim, sulmuesi rrallë herë shfaqej në fushë, tentativa të dëshpëruara të ndalura nga muri mbrojtës. Nëse skuadra jonë triumfoi në fushë, të njëjtën gjë bënë edhe tifozët në tribuna, të cilët fituan ndeshjen e tyre në tribuna. Me këtë fitore, Shqipëria kryeson grupin E me 10 pikë, 2 pikë më shumë se Çekia dhe Moldavia, që mbajnë respektivisht vendin e dytë dhe të 3-të. Polonia komplikon shumë rrugën drejt evropianit, pasi renditet e katërta me 6 pikë.



Kosova barazon me Zvicrën



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka barazuar 2-2 kundër favoritit të grupit, Zvicrës, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kësisoj, "Dardanët" janë rikthyer fuqishëm me lojë e rezultat pozitiv nën drejtimin e përgjdhësit Primozh Gliha, pas humbjes befasuese në qershor kundër Bjellorusisë. Heroi i ndeshjes pa dyshim ishte Vedat Muriqi, i cili realizoi të dy golat për Kosovën.

Zvicra kaloi në epërsi me golin e Remo Freuler, në minutën e 14-të. Megjithatë, Muriqi barazoi me gjuajtje me kokë pas harkimit të Milot Rashicës, në minutën e 65-të. Mysafirët e rikthyen sërish epërsinë falë autogolit të Amir Rahmanit, në minutën e 79-të. Mirëpo, as ky gol nuk i zmbrapsi "dardanët", të cilët besuan deri në fund në rezultat pozitiv dhe në sekondat e fundit të shtesës ia arritën qëllimit, kur Vedat Muriqi

shënoi sërish, kësaj radhe pas një kombinimi të shkëlqyeshëm Rrahmani-Korenica, ku ky i fundit asistoi me thembër për sulmuesin e Mallorcas, i cili u tregua i saktë nga brendësia e zonës, duke e dërguar topin në rrjetën e mysafirëve. Barazim ky që rikthen entuziazmin, jep shpresë për paraqitje edhe më të mira në vazhdim dhe pse jo edhe rikthim të fuqishëm në garën për kualifikim në Evropian.



Gjermania mposhti Serbinë, shpallet kampion bote në basketboll

MANILA, 10 SHTATOR - Gjermania është kampione e botës në basketboll. Në finale të Botërorit 2023, Gjermania e mposhti Serbinë me rezultat 83:77. Finalja e Botërorit është zhvilluar të dielën në Manila të Filipineve. Ndeshja

ishite dramatike dhe e hapur deri në fund. Shkëputjen e madhe gjermanët e bënë në çerekun e tretë, të cilin e fituan 22:10. Por më pas ndeshja u hap sërish dhe u vendos në aksionet e fundit. 21 sekonda para fundit, Dennis

Schroeder shënoi për 81:77. Në aksionet vijuese Serbia dështoi. Schroeder më pas realizoi dy gjuajtje të lira për 83:77, 12 sekonda para fundit. Rezultati më nuk ndryshoi. Gjermania ka fituar titullin e botës për herë të parë.

Gjermania shkarkon trajnerin Flick

Berlin, 10 shtator - Hansi Flick është pushuar nga puna si trajner i kombëtares gjermane.

Federata vendase ka filluar punën për të gjetur trajnerin e ri i cili do t'i udhëheqë për në "Euro

2024". Humbja 4-1 ndaj Japonisë në miqësore ishte fatale për të ardhmen e Flick dhe

tashmë deri në gjetjen e një tekniku tjetër, Rudi Voller do të jetë në krye përkohësisht.



NJOFTIM - KËRKESË PËR OFERTË

Prizren, 11.09.2023

Titulli: FURNIZIM ME PAJISJE PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHTIT

AUTORITETI KONTRAKTUES: N.P.T "QAUSHI"

I. LËNDA E MARRËVESHJES

Furnizim:

Furnizim me mbushëse për jogurt 1 litër

Furnizim me pajisje për dezinfektim në hyrje të objektit për stafin e kompanisë

Montimi i pajisjeve për përpunimin e qumështit (pasterizator automatik me kapacitet 3000 lit/h, seperatorin, mbushësen e jogurtit, mbushësen për kos)

Vendi për ekzekutim: Prizren

II. KUSHTET PËR OPERATORIN EKONOMIK I CILI DËSHIRON TA MARR TENDERIN

Kushtet e ofertës:

Afat kohorë: Dorëzimi i ofertës duhet të bëhet deri më datën 22.09.2023, ora 11:00

Vendi: Rr. "Gjevat Berisha", Nr.26 Prizren

Periudha e vlefshmërisë së tenderit: 120 ditë prej afatit të fundit

KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: Çmimi më i ulët dhe tenderuesi i përgjegjshëm

III. KËRKESA PËR DOSJEN E TENDERIT

Dosja e tenderit mund të kërkohet me shkrim përmes e-mailit nga operatorët ekonomik në autoritetin kontraktues ose direkt në zyrat e kompanisë "N.P.T "QAUSHI" më së largu deri më 16.09.2023.

Informata: Për më tepër informata referoju drejtpërdrejt tek kompania N.P.T "QAUSHI", Prizren; tel: 048/660017, e-mail: npt.qaushi@gmail.com

NJOFTIM - KËRKESË PËR OFERTË

Prizren, 11.09.2023

Titulli: FURNIZIM ME PAJISJE PËR PËRPUNIMIN E QUMËSHTIT

AUTORITETI KONTRAKTUES: N.P.T "QAUSHI"

I. LËNDA E MARRËVESHJES

Furnizim:

Furnizim me mbushëse të kosit 2 kg

Furnizim me seperator automatik 2000 – 3000 lit/h

Furnizimi me pasterizator automatik me kapacitet 3000 lit/h

Vendi për ekzekutim: Prizren

II. KUSHTET PËR OPERATORIN EKONOMIK I CILI DËSHIRON TA MARR TENDERIN

Kushtet e ofertës:

Afat kohorë: Dorëzimi i ofertës duhet të bëhet deri më datën 22.09.2023, ora 10:00

Vendi: Rr. "Gjevat Berisha", Nr.26 Prizren

Periudha e vlefshmërisë së tenderit: 120 ditë prej afatit të fundit

KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: Çmimi më i ulët dhe tenderuesi i përgjegjshëm

III. KËRKESA PËR DOSJEN E TENDERIT

Dosja e tenderit mund të kërkohet me shkrim përmes e-mailit nga operatorët ekonomik në autoritetin kontraktues ose direkt në zyrat e kompanisë "N.P.T "QAUSHI" më së largu deri më 16.09.2023.

Informata: Për më tepër informata referoju drejtpërdrejt tek kompania N.P.T "QAUSHI", Prizren; tel: 048/660017, e-mail: npt.qaushi@gmail.com

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Flamur Miftari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmendin Nixha".

- Flaka Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Lahë Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hysni Zajmi" (Nexhemdin Nixha).

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Arjeta Rizanaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Egzona Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Fadil Hisari" Prizren.

- AJET HAJRA, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së lartë "ARKITEKT SINANI" ish-shkolla "Boris Kidriç".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit të Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- ARDITA MORINA, shpall të pavlefshme ID e Fakultetit AAB, drejtimi JURIDIK me nr: FJUP/0027-T19/22.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit të Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- ENVER PEÇI, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së lartë Ekonomike Komerciale në Pejë, numër të dosjes: 183/1975 dhe numër të diplomës: 01-210/66.

